

Mergjyshi:Po punohet per te rrezuar Besen

nga Albaniassocer
E shtunë, 12 Prill 2014 16:23



Artan Mergjyshi, trajneri i Beses u tregua shume i zhgenjyer nga arbitrimi i ndeshjes se sotme. Kjo ndeshje ishte shume e rendesishme per ne sepse na duhej fitorja me doemos. Gjate gjithë kësaj jave është punuar kundër Beses. Është turp që po nenkembet një ekip me tradita si Besa. Gjithkund neper televizore ne fusha e ne korridorre ekipi jone po shumezohet me zeron. Tashme është krijuar një vorbull që na ka tërhequr brenda dhe do të jete e veshtire të dalim. Un mendoj se 70% jemi të rene. Ne ndeshjen e sotme u pa qarte që arbitrimi ishte tendencjuz. Ishin të pakten 4-5 kartona të kuqe për Laçin dhe një 3 penallti në favorin tonë. Qdo faull lojtaret e Laçit e rrethonin arbitrin duke i thënë fjale nga me të ndryshmet dhe kishte humbje kohet sistematike për të rifilluar lojen. Normalisht që edhe ekipi im gaboi shume para portes sepse rastet i patem por nervozizmi ishte i madh. Kur ka mungese rezultatesh faji është edhe i trajneri apo i stafit drejtues. Megjithate me duket se po luftojme kundër mullireve të ertes.